



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

Abstrakt i zgjeruar

Titulli i Punimit:

“ZHVILLIMI I KURRIKULËS TENDENCË PËR NGRITJE TË CILËSISË NË ARRITJET
AKADEMIKE TË NXËNËSVE”

Autorja:

Sara Rexhepi

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Arlinda Beka

Programi:

Programi i studimeve master: “Mësimdhënia dhe kurrikula”

Viti akademik:

20.05.2026

Hyrja

Nuk ka dyshim se kurrikula ka ndikim të rëndësishëm në arritjen e rezultateve të parapara nga mësimdhënësi e drejtëpërdrejtë edhe në rezultatet akademike të nxënësve. Duke ditur se mësimdhënësit janë ata të cilët në punën e tyre të përditshme janë gjithmonë në kontakt si me dokumentin e kurrikulës bërthamë e edhe me nxënësit, ky hulumtim ka për qëllim identifikimin e mangësive dhe sfidave në punën e tyre, të cilat rrjedhimisht ndikojnë në arritjet akademike të nxënësve. Pra, paraqitet nevoja që të hulumtohet më tepër rreth gjetjes së mangësive të cilat kanë si pasojë, arritjet akademike të dobëta sidomos në testet ndërkombëtare të standardizuara krahas pritshmërive. Me anë të këtij hulumtimi është analizuar rëndësia e kurrikulës dhe arritjeve

akademike të nxënësve, poashtu është eksploruar këndvështrimi i mësimdhënësve në rritjen e këtyre rezultateve të pritura nga nxënësit gjatë testimeve, më saktësisht testimit TIMSS. Gjithashtu, është marrë edhe këndvështrimi dhe opinioni i zyrtarëve të MASHT rreth procesit të testimit TIMSS.

Pyetjet kryesore

Pyetjet kërkimore kryesore të këtij hulumtimi janë: 1. Cilat aspekte të kurrikulës duhet të ndryshohen që të përmirësohen rezultatet në testimet ndërkombëtare? 2. Si ndikojnë mangësitë e kurrikulës aktuale në rezultatet e nxënësve kosovarë në testet ndërkombëtare të standardizuara dhe cilat janë fushat kryesore që kërkojnë përmirësim? 3. Çfarë mungesash të veçanta identifikohen në strukturën dhe përmbajtjen e kurrikulës shkollore që mund të ndikojnë në nivelet e ulëta të arritjeve akademike të nxënësve, veçanërisht në testet ndërkombëtare të standardizuara? 4. Çfarë përciptimesh kanë mësimdhënësit dhe zyrtarët e arsimit për lidhjen midis kurrikulës dhe performancës akademike të nxënësve në testet ndërkombëtare dhe si e vlerësojnë ata ndikimin e kurrikulës në arritjet akademike?

Metodologjia

Hulumtimi është realizuar duke intervistuar mësimdhënësit e ciklit fillor dhe zyrtarët e MASHT, me ndihmën e metodologjisë cilësore, përmes së cilës janë organizuar intervista gjysmë të strukturuar. Gjithsej në këtë studim morrën pjesë 8 mësimdhënës të arsimit fillor e gjithashtu dy zyrtarë nga MASHT. Këtij procesi i është shtuar edhe metodologjia sasiore për pasurimin e mëtutjeshëm të rezultateve eventuale me anë të analizimit të rezultateve të TIMSS, si të dhëna sekondare nga arkivat shtetërore.

Rezultatet kryesore

Rezultatet e këtij hulumtimi treguan se kurrikula si dokument bazë në të cilën ngritet i tërë sistemi arsimor, ka një rol të pakontestueshëm në arritjen e tërë komponenteve që parashihen aty si dhe në ngritjen e cilësisë së arsimit përmes rritjes së rezultateve të arritjeve akademike të nxënësve. Kjo padyshim që ndikon në cilësinë e arsimit e poashtu edhe në zhvillimin e shkollës në përgjithësi. Po ashtu, rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se ka nevojë për të ndryshuar disa komponente në dokumentin bërthamë të kurrikulës dhe në shkolla në mënyrë që të ketë ndryshime deri tek mënyra

e implementimit nga vetë akterët arsimor si mësimdhënësit apo drejtorët në institucionet arsimore. Gjithsesi se synimi i hukumtimi ishte që të identifikohen problemet aktuale të gjendjes arsimore në shkollat e Kosovës, të cilat ndikojnë në arritjet akademike të nxënësve si pasojë e këtyre mangësive dhe aspektet që duhet të punohet më shumë që të kemi rezultate të duhura.

Ky hulumtim shërben si bazë edhe për ngritjen e bashkëpunimit mes ekspertëve arsimorë dhe mësimdhënësve në eliminimin e këtyre mangësive, që të bazohet ndërtimi i kurrikulës krahas nevojave, shikuar nga vetë këndvështrimi i mësimdhënësve.

Diskutimi

Rezultatet e marra nga ky hulumtim tregojnë qartë se kurrikula si njëri nga dokumentet kyçe në sistemin arsimor të të gjitha vendeve, ka një rol shumë të madh në zbatimin dhe përmbushjen e qëllimeve, rezultateve dhe objektivave të një vendi. Kurrikula dhe zbatimi i saj implikojnë edhe arritjen e rezultateve të mira të nxënësve, sidomos në testimet ndërkombëtare të cilat tregojnë se sa nxënësit e një vendi janë në një linjë zhvillimi të aftësive dhe shkathtësive me një vend tjetër. Rëndësia e trajnimeve për mësimdhënësit para dhe gjatë shërbimit është një aspekt mjaft i rëndësishëm sepse i ndihmon dhe motivon mësimdhënësit për punë të mëtejshme me nxënës për të arritur kështu rezultate më të larta. Gjetjet gjithashtu treguan se mungon një hierarki llogaridhënie, duke filluar kështu nga mungesa e interpretimit të detajuar të rezultateve tek mësimdhënësit rreth arritjeve të nxënësve në testimet ndërkombëtare.

Përfundimet dhe rekomandimet

1. Ky studim ka treguar se zhvillimi i kurrikulës është tendencë për ngritje të cilësisë në arritjet akademike të nxënësve. Kurrikula ka një ndikim të rëndësishëm dhe transformues në zhvillimin e nxënësve në mënyrë që ata të bëhen nxënës me aftësi dhe shkathtësi që kërkohen nga trendet e zhvillimit të botës së shek XXI. Rezultatet e TIMSS tregojnë se angazhimi i nxënësve është një tregues kyç i performancës akademike. 2. Krijimi i mjediseve mësimore që inkurajojnë pjesëmarrje aktive, diskutime, eksperimentime dhe organizim i punës me bazë projektesh mund të rrisë angazhimin dhe të përmirësojë arritjet akademike. 3. Mungesa e trajnimeve të vazhdueshme për mësimdhënësit ka bërë që disa prej tyre të kenë vështirësi në implementimin e drejtë të kërkesave të kurrikulës. Investimi në trajnime të vazhdueshme për mësuesit, sidomos në metodologjitë aktive dhe eksperimentale do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatet dhe

cilësinë e tyre nga nxënësit. 4. Një tjetër përfundim i rëndësishëm është se përdorimi i teknologjisë dhe mjeteve digjitale luajnë rol shumë të madh për të mbështetur mësimin interaktiv dhe për të monitoruar progresin e nxënësve. Diferencimi i mësimi, që merr parasysh nivelin dhe nevojat e ndryshme të nxënësve, mund të ndihmojë në ngritjen e arritjeve dhe reduktimin e hendekut mes nxënësve me aftësi të ndryshme. Për më tepër, zhvillimi profesional i mësuesve në metodologjitë aktive dhe eksperimentale është thelbësor për të përmirësuar praktikën mësimore dhe rezultatet e nxënësve.

1. Trajnime të vazhdueshme për mësimdhënësit. 2. Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave. 3. Përditësim dhe përmirësim i teksteve dhe materialeve shkollore. 4. Rritja e mbështetjes institucionale si dhe vlerësim dhe monitorim i progresit. 5. Krijimi i një mjedisi motivues dhe mbështetës. 6. Mbështetja e kontekstit shkollor dhe shtëpiak është gjithashtu vendimtare.

Fjalët kyçe: *Arritje akademike, kurrikulë, ndryshime, nxënës, TIMSS, vlerësim*

Extended Abstract

Title of the diploma thesis:

“CURRICULUM DEVELOPMENT: A TREND TO IMPROVE THE QUALITY OF STUDENTS’ ACADEMIC ACHIEVEMENTS”

Author:

Sara Rexhepi

Mentor:

Prof. Asoc. Dr. Arlinda Beka

Program:

Master's degree program: "Teaching and Curriculum"

Academic year:

20.05.2026

Introduction

There is no doubt that the curriculum has a significant impact on the achievement of the results foreseen by the teacher and directly on the academic results of the students. Knowing that teachers are those who in their daily work are always in contact with both the core curriculum document and the students, this research aims to identify the shortcomings and challenges in their work, which consequently affect the academic achievements of the students. Therefore, there is a need to conduct more research on finding the shortcomings that result in poor academic achievements, especially in international standardized tests in addition to expectations. Through this research, the importance of the curriculum and the academic achievements of the students was analyzed, and the perspective of the teachers on increasing these results expected from the students during the tests, more precisely the TIMSS test, was also explored. In addition, the perspective and opinion of the MEST officials on the TIMSS testing process was also taken.

Key Questions

The key research questions of this research are: 1. What aspects of the curriculum need to be changed to improve results in international tests? 2. How do the shortcomings of the current curriculum affect the results of Kosovar students in international standardized tests and what are the main areas that require improvement? 3. What specific shortcomings are identified in the structure and content of the school curriculum that may affect the low levels of academic achievement of students, especially in international standardized tests? 4. What perceptions do teachers and education officials have about the relationship between the curriculum and students' academic performance in international tests and how do they assess the impact of the curriculum on academic achievement?

Methodology

The research was conducted by interviewing primary school teachers and MEST officials, using a qualitative methodology, through which semi-structured interviews were organized. A total of 8 primary school teachers and two MEST officials participated in this study. This process was supplemented by a quantitative methodology to further enrich the eventual results by analyzing TIMSS results, as secondary data from state archives.

Key findings

The results of this research showed that the curriculum as a basic document on which the entire education system is built, has an indisputable role in achieving all the components foreseen therein as well as in increasing the quality of education through increasing the results of students' academic achievements. This undoubtedly affects the quality of education and also the development of the school in general. Also, the results of this research show that there is a need to change some components in the core curriculum document and in schools in order to have changes up to the way of implementation by the educational actors themselves such as teachers or directors in educational institutions. However, the aim of the research was to identify the current problems of the educational situation in Kosovo's schools, which affect the academic achievements of students as a result of these shortcomings and the aspects that need to be worked on more in order to have the right results.

This research also serves as a basis for increasing cooperation between educational experts and teachers in eliminating these shortcomings, so that curriculum construction can be based on needs, viewed from the teachers' own perspective.

Discussion

The results obtained from this research clearly show that the curriculum as one of the key documents in the education system of all countries, has a very important role in the implementation and fulfillment of the goals, results and objectives of a country. The curriculum and its implementation also imply the achievement of good student results, especially in international tests which show how well students of a country are in line with the development of skills and abilities with another country. The importance of training for teachers before and during service is a very significant aspect because it helps and motivates teachers to further work with students in order to achieve higher results. The findings also showed that there is a lack of a hierarchy of accountability, starting from the lack of detailed interpretation of the results to teachers about the achievements of students in international tests.

Conclusions and recommendations

1. This study has shown that curriculum development is a trend towards improving the quality of students' academic achievements. Curriculum has a significant and transformative impact on the development of students so that they become learners with the skills and abilities required by the development trends of the 21st century world. TIMSS results show that student engagement is a key indicator of academic performance. 2. Creating learning environments that encourage active participation, discussions, experimentation, and project-based work can increase engagement and improve academic achievements. 3. The lack of ongoing training for teachers has led some of them to have difficulties in properly implementing curriculum requirements. Investing in ongoing training for teachers, especially in active and experimental methodologies, will have a direct impact on the results and quality of their students. 4. Another important conclusion is that the use of technology and digital tools play a very important role in supporting interactive learning and monitoring student progress. Differentiating teaching, which takes into account the different levels and needs of students, can help raise achievement and reduce the gap between students with different abilities. Furthermore, professional development of teachers in active and experiential methodologies is essential to improve teaching practice and student outcomes.

1. Continuous training for teachers. 2. Improving school infrastructure. 3. 3. Updating and improving textbooks and teaching materials. 4. Increasing institutional support as well as assessing and monitoring progress. 5. Creating a motivating and supportive environment. 6. Supporting the school and home context is also crucial.

Keywords: *Academic achievement, curriculum, changes, students, TIMSS, assessment*